



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 34

Tiranë – E hënë, 9 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5447, datë 30.8.2019	Për miratimin e raportit për “Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 77, datë 6.9.2019	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “eHealth coordinator-full time”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 8
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5545, datë 9.9.2019	Për shpalljen e vendit vakant për pozicionin “Këshilltar Ekonomik” 9



V E N D I M

Nr. 5447, datë 23.7.2019

V Ë R E N:

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR
“MBYLLJEN E PROCEDURËS SË
FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË
“ALPINE BAU GMBH FILIALI TIRANË”
SH.P.K., SHOQËRI NË FALIMENTIM”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR: Ardian Kalia

asistuar prej sekretares gjyqësore Beglie Nura, sot më datë 23.7.2019, në funksion të shqyrtimit të çështjes civile-tregtare me nr. 152 regj. themeltar, në përfundim të seancës për “Mbledhjen e përgjithshme të Kreditorëve Falimentarë të Shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k.” në proces falimentimi”, të zhvilluar në sallën nr. 12, Dhoma Penale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me shqyrtimin e kërkesës e cila i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., në proces falimenti, me seli në adresën: rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati 5, apartamenti 8, Tiranë-Shqipëri, me administrator Zj. Shpresa Breçani, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara - El”, shkalla e, ap. 1, Tiranë, në cilësinë e administratores së falimentimit të shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k.

OBJEKTI: Miratimin e raportit për: “Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k. shoqëri në falimentim”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, neni 163 i këtij ligji.

Gjykata, pasi dëgjoi debatin e kreditorëve falimentarë të shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k. në proces falimentimi, pjesëmarrës në mbledhjen e përgjithshme të kreditorëve, në përfundim të mbledhjes, procedoi me kalimin në votim të raportit të hartuar nga ana e administratores së falimentit për **“Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”**, raport i cili u miratua nga ana e kreditorëve falimentarë të pranishëm në mbledhjen e kreditorëve të shoqërisë, në përfundim pasi shqyrtoi çështjen në tërësi:

1. Se shoqëria “ALPINE-BAU” sh.p.k., është një person juridik tregtar, subjekt i të drejtës tregtare shqiptare, i krijuar dhe regjistruar konform ligjit të kohës në datën 13.7.2007, në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Në ekstratin e kësaj shoqërie tregtare, rezulton të jetë është përcaktuar qartë selia e kësaj shoqërie: rruga e Elbasanit, pallati “Gener 2”, kati 3, Tiranë, e cila në vijim është ndryshuar me vendim të kësaj shoqërie, të regjistruar në QKR, në adresën e re: rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati 5, apartamenti 8, Tiranë.

2. Gjithashtu nga aktet bazë të kësaj shoqërie ka rezultuar se, kapitali themeltar i saj rezulton në vlerën 100 000,00 lekë dhe objekti i veprimtarisë së saj tregtare ka rezultuar të jetë: *“Kryerja e punimeve të ndërtimit të të gjitha llojeve (vepra arti), përfshirë ndërtimin e godinave dhe instalimeve të çdo lloji (vepra arti). Aktivitet kryesor tregtar dhe qiramarrja e qiradhbënia e mjeteve të prodhimit dhe ndërtimit të të gjitha llojeve. Shitja dhe shpërndarja e elementeve prej betoni të armuar. Ndërmarrja e instalimeve elektrike dhe montimi i linjave elektrike. Mbajtja e raporteve të kontabilitetit për bizneset e ndërtimit. Dhënia me qira dhe marrja me qira e pasurive të paluajtshme. Zhvillimi i investimeve (kapitaleve) dhe realizimi i projekteve. Projektimi, planifikimi dhe sipërmarrja e ndërtimeve të kërkuara në lartësi dhe në thellësi, ndërtimi i tuneleve, sipërmarrjeve. Projektimi, planifikimi dhe sipërmarrja e ndërtimeve të dubura, të të gjitha llojeve të objekteve të artit dhe dizenjove. Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit”.*

3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka rezultuar nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie tregtare se, përfaqësues ligjor i shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., ka qenë Z. Manfred Karl Willi Deppe, me afat të emërimit të tij, nga data 28.6.2010 deri në datën 28.6.2015. Ortak i shoqërisë është Shoqëria “ALPINE Bau GmbH”, me kuotë pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë 100,00 pjesë, ose në masën 100%;

4. Duke qenë se veprimtaria e shoqërisë ka rezultuar me humbje të kapitaleve për tre vite rresht dhe, konkretisht në vitet 2009, 2010, 2011, kjo për shkak të vështirësive financiare që ka kaluar ky subjekt tregtar, humbjet ekonomike, kanë passjellë mbingarkesën me detyrime dhe paafësi paguese të detyrimeve si ndaj shtetit ashtu edhe



ndaj të tretëve. Pikërisht duke u bazuar në këtë premisë, pra referuar gjendjes financiare të përkeqësuar të kësaj shoqërie, ka rezultuar se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është vënë në lëvizje me kërkesën e paraqitur nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, me anën e kërkesës me objekt: **“Çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE BAU” sh.p.k.”**.

5. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërke, rezulton se ka disponuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Civil Tregtar i saj, me vendimin nr. 5069, datë 23.4.2014, duke vendosur ndër të tjera sa vijon:

- “Hapjen në orën 11:45 të datës 23.4.2014 të procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., me përfaqësues ligjor Manfred Karl Willi Deppe, me seli në Tiranë, rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati 5, apartamenti 8.

- Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., Zj. Shpresa Dem Breçani, eksperte kontabël e regjistruar, e licensuar në fushën e administrimit të Falimentit me nr. 9 licence, datë 15.10.2012, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara - El”, shkalla e, ap. 1, Tiranë.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k., të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, konform nenit 141 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, i ndryshuar, brenda 30 ditëve, nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

- Personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k., duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ALPINE-BAU” për verifikim, të mbahet brenda 50 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e pretendimeve.

- Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., duke i dërguar një kopje të tij Buletinit të Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të

Paluajtshme me qellim njoftimin për të gjitha ZVRPP-të dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

- Një kopje e këtij vendimi gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha Bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

- Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ALPINE-BAU” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe organit tatimor Tiranë”.

6. Në vijim të procedurave ligjore falimentare të kësaj shoqërie tregtare, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji për falimentin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, (i ndryshuar), rezulton të jenë ndërmarrë të gjitha hapat procedural ligjorë që parashikon ky ligj. Më konkretisht, rezulton që, pas paraqitjes së pretendimeve dhe dokumentacionit përkatës vërtetues, të jetë mbajtur mbledhja e përgjithshme e kreditorëve falimentarë të kësaj shoqërie, është krijuar Komiteti i Kreditorëve dhe në vijim është miratuar edhe tabela përkatëse e detyrimeve apo, e të drejtave të kërimit të çdo kreditori kundrejt shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k.

7. Në funksion të këtij gjykimi, rezulton e provuar se, në përmbushje të të drejtave që u burojnë kreditorëve falimentarë nga ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, është mbajtur mbledhja e përgjithshme e kreditorëve falimentarë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni tregtar, me objekt “Shqyrtimin dhe miratimin e raportit të hartuar nga ana e administres së falimentit Zj. Shpresa Breçani: **Mbi ndjekjen e procedurave të falimentit të subjektit debitor “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim**”, në përfundim të së cilës, është disponuar me vendimin nr. 437 akti, datë 4.3.2016, duke u vendosur veç të tjerash sa vijon:

- “Konstatimin e miratimit nga ana e Asamblesë së Kreditorëve Falimentarë të shoqërisë “ALPINE-BAU”



sh.p.k., në proces falimentimi, në mbledhjen e kreditorëve më datë 4.3.2016, të raportit “Mbi ndjekjen e procedurave të falimentit të subjektit debitor “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”, të hartuar nga ana e administratorit të falimentit të kësaj shoqërie.

- Urdhërohet administratorja e falimentit të vijojë me procedurat e mëtejshme të ndarjes së masës së falimentit të krijuar deri në këtë moment, sipas përcaktimeve të bëra në raportin “Mbi ndjekjen e procedurave të falimentit të subjektit debitor “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”, si dhe me procedurat e mëtejshme falimentare, në bazë të ligjit mbi falimentin.

- Urdhërohet administratorja e falimentit të shoqërisë “ALPINE-BAU” sh.p.k., në proces falimenti, të informojë Gjykatën e Falimentit për procedurat e mëtejshme ligjore”.

8. Në vijim të procedurave të mëtejshme falimentare të kësaj shoqërie tregtare, gjykata çmon të theksojë se, është verifikuar periodikisht nga ana e kësaj Gjykate, në respekt të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit tregtar nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, lidhur me krijimin e masës së mbetur të falimentit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve tërësore të detyrimeve që rëndojnë mbi shoqërinë, ndaj kreditorëve falimentarë. Për këtë arsye, nga ana e kësaj gjykate, janë mbajtur periodikisht në vijim disa mbledhje të përgjithshme të kreditorëve falimentarë, duke kërkuar vazhdimisht informacion nga administratori i falimentit për ecurinë e kësaj procedure.

9. Në funksion të përmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore që burojnë nga dispozitat që disiplinonin procedurat falimentare sipas ligjit të mësipërm, gjykata ka konstatuar se, ka patur një pritshmëri për sigurimin e një detyrimi monetar nga njëri prej debitorëve të shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., e konkretisht kundrejt Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), në shumën 51 130 553 (pesëdhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë. Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga procedurat falimentare, ka rezultuar se, ky detyrim ka qenë i kërkueshëm si pjesë e një detyrimi që buronte nga kontrata e lidhur nga ana e kësaj shoqërie me këtë autoritet shtetëror, sikurse ka qenë e përcaktuar edhe në aktin, certifikatë përfundimtare e pagimit nr. 28, datë 16.9.2013, lëshuar nga ana e ARRSH-së, në bazë të kontratës së datës 30.5.2007.

10. Në seancë gjyqsore, nga ana e administratorit falimentar Zj. Shpresa Breçani, u paraqit në mënyrë formale akti, raport për **“Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”**, në tekstin integral të të cilit, është shpjeguar në terma teknikë ekonomikë e ligjorë se, administratori i falimentit ka avancuar në mënyrë të përsëritur nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor, kërkesë përpara A.RR.SH-së, në funksion të krijimit të masës së falimentit, për përmbushjen e pjesës së mbetur të detyrimit monetar që ky autoritet ka patur ndaj shoqërisë “Alpine bau” sh.p.k., në shumën 51 130 553 lekë. Në gjykim u provua se, nga ana e këtij autoriteti shtetëror është kthyer përgjigje me shkrim përmbaruesit gjyqësor, formalisht të dokumentuar me aktin me nr. 3100/4 prot, datë 30.5.2017, **“Kthim përgjigje”, me anën e të cilit është shpjeguar ndër të tjera se, “... shuma e kërkuar prej 322 408,83 euro, i është mbajtur në certifikatën finale kontraktorit të punimeve të segmentit Levan-Vlorë, bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, për disa pasaktësi në zbatimin e projektit”**.

11. Në lidhje me sa sipër, nga ana e administratorit të falimentit është pretenduar se, në kushtet e pamundësisë së krijimit të masës tërësore të falimentit dhe pamundësisë për të mbuluar shpenzimet e mëtejshme për procedurat falimentare për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së kësaj shoqërie, për shkaqet e cituara në raportin e paraqitur me shkrim, bazuar në nenin 163 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, gjykata duhet të disponojë me vendim për “Mbylljen e procedurave falimentare të kësaj shoqërie tregtare”.

12. E pyetur në gjykim nga ana e gjykatës, nëse ekzistonin pritshmëri nga pikëpamja ligjore, për përmbushjen e detyrimit monetar që ARRSH-ja ka kundrejt shoqërisë “Alpine bau” sh.p.k., në proces falimenti, administratorja e falimentit u shpreh se, sipas përgjigjes së dhënë me shkrim nga ana e këtij autoriteti shtetëror, ky detyrim nuk njihej dhe nuk pranohej të përmbushej pasi ishte gjetur si shkelje nga ana e autoritetit shtetëror të Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me pasaktësi në zbatimin e projektit.

13. Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi raportin formal të paraqitur nga ana e administratorit të falimentit të shoqërisë “Alpine bau” sh.p.k., për



“Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”, pasi shqyrtoi aktet bashkëngjitur këtij akti formal, në interpretim të dispozitave ligjore të cilat dispijlojnë falimentin e në veçanti, mbylljen e procedurave falimentare për shkak të paaftësisë pague, me posaçërisht nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, vlerëson se, kërkesa e paraqitur nga ana e administratorit falimentar është e mbështetur ligjërisht e në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

14. Neni 163 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht sa vijon: *“Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht”.*

15. Në nenin 1 të këtij ligji përcaktohet se: *“Procedura e falimentimit ka për qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër me synimin kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij”.* Nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë se, janë njohur dhe pranuar dy mënyra të shlyerjes kolektive të detyrimeve të debitorit: a) nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive dhe shpërndarjes së të ardhurave; b) nëpërmjet plan riorganizimit/një marrëveshjeje, që synon ruajtjen e veprimtarisë së debitorit.

16. Nga përcaktimi i këtij neni, gjykata, çmon në rastin konkret objekt gjykimi nuk ndodhemi përpara një plani riorganizimi i cili i nënshtrohet rregullimeve të parashikuara konkretisht në këtë ligj, por shlyerjes në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave.

17. Ligji i posaçëm mbi falimentin, edhe pse në nenin 1 të tij jep qëllimin e procedurës së falimentimit dhe mënyrat e realizimit të tij, nuk përcakton shprehimisht pasojat që vijnë nga likuidimi për shkak të falimentimit i debitorit/shoqërisë; nuk përmban dispozita të veçanta mbi pasojat për likuidimin për shkak falimentimi lidhur me vetë debitorin shoqëri, gjë e cila passjell dhe zbatimin e dispozitave të ligjit tregtar mbi likuidimin e një shoqërie tregtare, përsa i përket pasojave (ligji për falimentimin parashikon vetem shpërndarjen e të ardhurave dhe të drejtat e

kreditorëve të falimentimit mbas mbarimit të procedurës së falimentimit sipas neneve 164-167).

18. Pavaresisht shkakut të likuidimit (vullnetar apo falimentim) në thelb qendron e njëjta situatë: likuidim i të gjithë pasurisë së subjektit/shoqërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave. Në ligjin për shoqëritë tregtare gjejmë të pasqyruar pasojat që vijnë nga likuidimi në përfundim të tij: prishja e shoqërisë dhe çrregjistrimi i shoqërisë, pasi kemi të bëjmë me një subjekt që nuk mund të vazhdojë me aktivitetin e tij, të cilit tashmë i është likuiduar e gjithë pasuria dhe shpërndarë të ardhurat.

19. Pasoja, prishja e shoqërisë dhe çrregjistrimi i shoqërisë nga likuidimi për shkak falimentimi është i parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, me ndryshimet. Neni 99 i tij, sipas së cilit përcaktohet se: *“1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet: b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; ...5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit...”.*

20. Nga ana tjetër, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, neni 51, i ndryshuar, ligj i cili gjithashtu parashikon dhe rregullon edhe pasojat e çrregjistrimit në nenin 53 të tij, përcakton çrregjistrimi me vendim gjyqësor: *“Subjekti mund të çrregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari. QKR-ja çrregjistron kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset çrregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte, ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit.”*

21. Nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështjeje, gjykata krijon bindjen e plotë të brendshme se, jemi



në kushtet kur ka pamjaftueshmëri të dukshme të pasurive të shoqërisë për të mbuluar procedurat e mëtejshme falimentare, situatë e cila rezulton të jetë pasqyruar në mënyrë evidente në terma teknikë financiarë edhe në raportin e paraqitur nga ana e administratorit të falimentit të shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., për *“Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., shoqëri në falimentim”*.

22. Në këtë kuadër, gjykata çmon të theksojë se, gjatë seancës së mbajtur nga ana e kësaj gjykate, nga ana e administratorit të falimentit u ngritën madje edhe pretendime në lidhje me mungesën tërësore të mjeteve monetare për të mbuluar financiarisht shpenzimet e administratorit falimentar pasi, nga ana e administratës fiskale vendore ishte sekuestruar një shumë e cila kishte pikërisht këtë destinacion.

23. Në përfundim, gjykata, pasi krijoi bindjen e plotë të brendshme se, plotësohen kushtet me të cilat ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, lidh mundësinë e mbylljes së procedurave falimentare, për shkak të mungesës apo, të pamjaftueshmërisë së pasurive të shoqërisë në proces falimenti për të mbuluar këto procedura, çmon të disponojë me pranimin e kërkesës së paraqitur nga ana e administratorit të falimentit të shoqërisë “Alpine Bau” sh.p.k., në proces falimenti për mbylljen e procedurave të falimentimit të kësaj shoqërie.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-308 të K. Pr. Civile, nenin 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., me NIPT K71931002K, me seli në adresën: rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 8, shkalla 3, kati 5, apartamenti 8, Tiranë-Shqipëri, me administrator falimenti, Zj. Shpresa Breçani, me adresë, rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara - El”, shkalla e, ap. 1, Tiranë, duke e shpallur si shoqëri e falimentuar.

- Urdhërohet çrregjistrimi i shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., nga regjistri

tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., në Buletin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

- Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

- Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet personalisht administratorës së falimentimit Shpresa Breçani.

- Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet nga administratorja e falimentimit personalisht kreditorëve të falimentimit dhe debitorit shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., në falimentim.

- Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “Alpine Bau GMBH Filiali Tiranë” sh.p.k., bashke me raportin e paraqitur nga ana e administratorës së falimentimit Shpresa Breçani, t’i komunikohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

- Administratori i falimentimit dhe kreditorët e falimentimit kanë të drejtë të paraqesin kërkesë para kësaj gjykate për shpërndarje të vonuar në kushtet e nenit 166 dhe vijues të ligjit.

- Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentimin.

- Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon sipas ligjit, nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar ose, nga dita e nesërme e



shpalljes publike në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës dhe në Buletin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

U shpall në Tiranë, sot me datë 23.7.2019.

SEKRETARE
BEGLIE NURA

GJYQTAR
ARDIAN KALIA

KËRKESË

Nr. 77, datë 6.9.2019

PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS “eHEALTH COORDINATOR-FULL TIME”, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

09th of September 2019

ALBANIA

ALBANIA HEALTH SYSTEM IMPROVEMENT
PROJECT (HSIP)

LOAN NO: 8466 AL.

PROJECT ID NUMBER: P144688

Assignment Title: "E-Health Coordinator Full time"

Reference No. HSIP/CS/IC/06-2019

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services. The consulting services (“the Services”) include hiring of a local individual consultant for the position of **"E-Health Coordinator Full time"**.

The e-Health Coordinator will be responsible for coordination and monitoring of e-health related project activities, progress reporting and provision of technical assistance to the MoH divisions and other organizations involved in related activities.

The e-Health Coordinator will be responsible for:

- Timely implementation of e-Health related component activities;
- Ongoing monitoring of execution of project implementation plan, procurement plan and contracts;

- Timely submission of monitoring reports, according to project documentation and project operation manual, in accordance with the legislation of the Republic of Albania and the World Bank, and other reports upon requests;

- Preparation of materials required for project supervision by the World Bank's project team and audit by external auditors;

- Ensuring confidentiality and non-disclosure of official and commercial secrets.

The e-Health Coordinator will be hired from the Ministry of Health and Social Protection of Albania, through a selection process, under a full time basis.

He/she will report directly to the Overall Project Coordinator and the Project Manager. He/she will work in close collaboration with IT Department of Ministry of Health and Social Protection, other project beneficiaries and World Bank team, during the course of the project implementation.

The qualification criteria are:

- The Master Degree in information systems, informatics, computer science, electronics, electrical engineering, natural sciences or other relevant field;

- Minimum 5, preferably 10 years of professional experience in the field, including experience with government systems;

- Proven previous experiences in designing and developing IT systems in Public and Private Sector;

- Previous experience in health and/or health insurance computerization would be an advantage;

- Experience in similar assignments especially with public administration will be an asset;

- Experience of participation and working with in multidisciplinary teams;

- Previous Experience working with international agencies projects, preferably World Bank funded project;

- Previous experience working with foreign donors will be an advantage;

- Fluency in both written and spoken English;

The Ministry of Health, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible individual local consultants (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide



information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	General Qualifications	30 points
2.	Relevant Experience in the field of the assignment	50 points
3.	English language and experience in the region	20 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers* (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. The consultant should be an **Individual Local Consultant**. The selection method to be applied is **Individual Consultant Consultants (IC)**, in accordance with the procedures set out the World Bank's *Guidelines Selection and Employment of Consultants Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers* (January 2011, revised July 2014).

Consultant shall perform the Services during the period commencing **October 2019** and continuing through **February 2021**, under a time base contract. The consultant will be hired on a full time basis. Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **September 23rd, 2019**.

Ministry of Health and Social Protection

Address: Rruga e Kavajës, No. 53, Tirana-Albania

Project Coordination Unit (PCU)

Health System Improvement Project (HSIP)

Att: Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

BlerinaDudushi@shendetesia.gov.al

NJOFTIM

Nr. 5545, datë 9.9.2019

**PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT
PËR POZICIONIN “KËSHILLTAR
EKONOMIK”**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton personat e interesuar të aplikojnë për pozicionin e “këshilltar ekonomik” në këtë institucion.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e këshilltarit ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3,

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi, me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave.

b. Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

c. Të ketë shtatë vite përvojë pune në sektorin financiar.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë



për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

- Kopje të dokumenteve [diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar)].

- Dëshmi penaliteti.

- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën; rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019